



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 390/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.06.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Sulollari” sh.p.k. në procedurën e “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-59831-03-29-2018, me objekt : *Loti 3 “Riparim Mirëmbajtje e Sistemeve të Ngrohjes dhe të ujit sanitar me kaldaja, sistemeve të ngrohjes-ftohjes me chillera, të stacionit qëndror të pompave dhe sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm, të elektropomave, në godinat e shërbimeve spitalore në QSUT”, me fond limit 19,943,547 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 27.04.2018 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë.*

Ankimues:

Operatori ekonomik “Sulollari” sh.p.k
Adresa: Rruga “Muhamet Gjollësia”, 71/3, Tiranë

Autoriteti kontraktor:

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
Adresa: Rruga e Dibrës Nr. 372, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,


V ë r e n: I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.



II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 30.03.2018, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-59831-03-29-2018, me objekt : *Loti 3 “Riparim Mirëmbajtje e Sistemeve të Ngrohjes dhe të ujit sanitar me kaldaja, sistemeve të ngrohjes-ftohjes me chillera, të stacionit qëndror të pompave dhe sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm, të elektropomave, në godinat e shërbimeve spitalore në QSUT*”, me fond limit 19,943,547 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 27.04.2018 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë.

II.2 Në datën 27.04.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor, ky i fundit në datë 07.05.2018 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht (sipas informacionit të autoritetit kontraktor):

1. “Sulollari” sh.p.k.	14,300,000	lekë pa tvsh skualifikuar
2. “Superior Klima” sh.p.k.	14,957,660.25	lekë pa tvsh kualifikuar
3. “Klima Teknika TB2” sh.p.k.	15,556,840	lekë pa tvsh skualifikuar

II.4. Në datën 07.05.2018 operatori ekonomik “Sulollari” shpk, është njoftuar për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

OE bazuar në DST pika 3.3 Kapaciteti Teknik, nënpika d), ka dorëzuar IQT vetëm për 1 saldator – në DST janë kërkuar 2 saldator. OE nuk ka dorëzuar IQT për 1 specialist kondicionimi. Në zbatim të Ligjit nr. 8734 dt.01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike” (i ndryshuar) si dhe Rregullores së Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet Pajisjet dhe Instalimet Elektrike, pjesa e parë (sigurimi teknik) pika 1-12, paragrafi 3: “...kontrolli injohurive mbi sigurimin teknik behet 1 (një) herë në vit”; OE ka dorëzuar për z. Ervin Zaka IQT për Teknik kondicioneri/hidraulik/elektracist/saldator të lëshuar në dt.26.03.2015

II.5. Në datën 15.03.2018 operatori ekonomik “Sulollari” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me pretendimet si më poshtë:

[...]

Në datën 27.04.2018 kemi marrë pjesë në procedurën e zhvilluar nga autoriteti kontraktor. Në datën 07.05.2018 jemi njohur me vlerësimin nga ana e AK-së dhe shoqëria jonë është skualifikuar me arsyet e mësipërme.

Vlerësimi i AK-së është totalisht i gabuar dhe në kundërshtim të plotë me LPP-në dhe RrPP-në. Shoqëria jonë nuk është dakkord me vlerësimin dhe skualifikimin e sj nga kjo procedurë prokurimi e në këto kushte bazuar në nenin 63 pika 2 e LPP-së i ndryshuar, po ju paraqesim ankesën tonë si më poshtë: Ak-ja në kriteret e vecanta të kualifikimit për Lotin 3 ka kërkuar :

Operatori ekonomik duhet te deshmoje se ka te punesuar punonjesit me kualifikime teknike nga inspektoriati Shteteror Pergjegjes për Sigurinë e Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike ose nga një organ i akredituar çertifikues personeli (Trup Certifikues) për fushën përkatëse ne specialitetet si me poshte:

- 3 punonjes elektriciste
- 2 punonjes mekanike
- 2 punonjes saldator me patente ose çertifikatë
- 4 punonjes instalator termo teknike
- 1 punonjes hidraulik
- 2 punonjes elektromekanike
- 2 specialiste kondicionimi

Për plotësimin e këtij kriteri shoqëria jonë ka paraqitur të gjithë punonjësit e kërkuar sa më sipër si në numër dhe në profesionin përkatës. Pretendimi i AK-së është vetëm për një punonjës tonë konkretisht Z. E.Z. i cili plotëson kriterin e punonjësit dhe specialistit kondicioner/hidraulik/elektracist/saldator. Në fakt pretendimi i AK-së nuk është nëse ky punonjës i zotëron apo jo specialitetet e kërkuar5a në kriteret e vecanta të kualifikimit, pasi ky fakt është i qartë dhe për autoritetin, por ajo që autoriteti kontraktor pretendon dhe ka nxjerrë si arsye skualifikimi është fakti se: OE ka dorëzuar për Z.E.Z. IQT për teknik kondicioner/hidraulik/elektracist/saldator të lëshuar në datën 26.03.2015.

E kundështojme këtë arsye skualifikimi të AK-së duke parashtruar:

Së pari në rast se shqyrtojmë me vëmendje kriterin e kërkuar nga AK-ja vërejmë se në asnjë rresht apo paragraf nuk parashikohet që punonjësit me kualifikime teknike të jenë të certifikuar për vitin

2018 apo jo më parë se viti 2018. Pra autoriteti kontraktor ka skualifikuar shoqërië tonë në kundështim të plotë me nenin 53 pika 3 të LPP-së, Referojmë neninin [...].

Referuar kësaj bazëe ligjore ju bëjmë me dije se autoriteti kontraktor mund të vlerësojë një ofertë vetëm mbi bazën e kriterëve të qarta të publikuara në dst dhe jo mbi bazn e kriterëve që nuk ja ka bërë të qartë apo publikuar OE-ve. Së dyti arsyetimi dhe baza ligjore e përdorur nga autoriteti kontraktor nuk vlen në këtë rast pasi :

Në nenin 9 të ligjit nr. 8734 datë 01.02.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike parashikohetse[...] Referojmë nenin[...]. Po kështu ehe rregullorja përkatëse në pikën 1-2 parashikon Kontrollin peiodik 1-herë në vit të njohurive të punonjësve. Referuar sa më sipër rezulton qartë se kontrolli periodik është detyrë eksluzive e Punëdhënësit e cila bëhet në momentin e realizimit të punës përkatëse atyku do të jeen dhe instruksionet përkatëse. Pra ky moment i takon procesit të ekzekutimit të kontratës dhe monitorohet së pari nga punëdhënësi e së dyti nga autoriteti kontraktor kur realizohet kontrata. Së treti Autoriteti Kontraktor ka patur gjithë mundësinë të bindej se ne i plotësojmë kriteret e kualifikimit e konkretisht të bindej se Z.E.Z. është saldator dhe specialist kondicioner/hidraulik/elektracist pasi; Shoqëria jonë prej 3 vitesh e realizuar me sukses (provuar me vërtetimin e realizimit nga Autoriteti Kontraktor) këtë procedurë prokurimi dhe punonjësi i mësipërm ka kryer ekzaktësisht punën e kërkuar nga autoriteti.

Në listëpagesat e shoqërisë të dorëzuara në sistemin elektronik të prokurimeve rezulton se punonjësi i mësipërm, e në rast se ju do të kishit pretendime për specialitetin e këtij punonjësi mund të kishit kërkuar sqarime. Referojmë nenin 53 të LPP-së[...] , bazuar në këtë nen, i bëjmë me dije AK-së se nëse do të kishte ndonjë paqartësi mund të kërkonte sqarimet përkatëse, fakt i cili rezulton se nuk ka ndodhur. Së katërti Shoqëria jonë ka dhënë ofertën më të ulët në këtë procedurë prokurimi dhe konkretisht nga fondi XXXX ka ofertuar me vlerën XXXXXlekë , ndërkohë që operatori ekonomik që autoriteti kontraktor ka kualifikuar në vend të parë ka vlerën XXXXX lekë, pra rreth XXXX të reja më shumë se ofertat jonë. Referojmë nenin 1 dhe 2 të LPP-së [...] Referuar vlerësimin të AK-së rezulton se ky parim i LPP-së është shkelur duke skualifikuar pa të drejtë shoqërinë tonë. Si përfundim bazuar në arsyetimin dhe argumentat e parashtruara sa mësipër shoqëria jonë kërkon rivlerësimin e kësaj procedure prokurimi duke e kualifikuar dhe shpallur fituese.

II.6. Autoriteti Kontraktor me shkresën nr. 2493/4prot., datë 17.05.2018, i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim të shqyrtimit të ankesës autoriteti kontraktor vendos të mos e pranojë ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

II.7. Në datën 25.05.2018 operatori ekonomik ankimues "Sulollari" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 2493/6 prot., datë 04.06.2018 protokolluar me tonën me numër 1003/2 prot., datë 04.06.2018, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Sulollari” sh.p.k. për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*OE bazuar në DST pika 3.3 Kapaciteti Teknik, nën-pika d), ka dorëzuar IQT vetëm për 1 saldator – në DST janë kërkuar 2 saldator. OE nuk ka dorëzuar IQT për 1 specialist kondicionimi. Në zbatim të Ligjit nr. 8734 dt.01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike” (i ndryshuar) si dhe Rregullores së Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet Pajisjet dhe Instalimet Elektrike, pjesa e parë (sigurimi teknik) pika 1-12, paragrafi 3: “...kontrolli injohurive mbi sigurimin teknik behet 1 (një) herë në vit”; OE ka dorëzuar për z. Ervin Zaka IQT për Teknik kondicioneri/hidraulik/elektricit/saldator të lëshuar në dt.26.03.2015”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Në pikën 2.3. të shtojcës 8, “Kapaciteti teknik”, gërma d) Loti 3 në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik duhet të deshmojë se ka të punësuar punonjesit me kualifikime teknike nga inspektoriati Shtetëror Pergjegjes për Sigurinë e Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike ose nga një organ i akredituar çertifikues personeli (Trup Certifikues) për fushën përkatëse në specialitetet si më poshtë:

- 3 punonjes elektriciste
- 2 punonjes mekanike
- 2 punonjes saldator me patente ose çertifikatë
- 4 punonjes instalator termo teknike
- 1 punonjes hidraulik
- 2 punonjes elektromekanike
- 2 specialiste kondicionimi

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik “Sulollari” sh.p.k, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Dëshmi kualifikimi lëshuar nga Trup Certifikues TPCE për z. A.S, profesion Elektricit, lëshuar datë 20.04.2018-19.04.2019

Dëshmi kualifikimi lëshuar nga Trup Certifikues TPCE për z. F.Y, profesion Elektricit, lëshuar datë 20.04.2018-19.04.2019

Dëshmi kualifikimi lëshuar nga Trup Certifikues TPCE për z. Q.D, profesion El/Mekanik, lëshuar datë 20.04.2018-19.04.2019

Dëshmi kualifikimi lëshuar nga Trup Certifikues TPCE për z. A.Rr, profesion El/Mekanik, lëshuar datë 20.04.2018-19.04.2019

Dëshmi kualifikimi lëshuar nga Trup Certifikues TPCE për z. L.Sh, profesion Instalator termotek, lëshuar datë 20.04.2018-19.04.2019

Dëshmi kualifikimi lëshuar nga Trup Certifikues TPCE për z. E.N, profesion Tek/Kondicioner, lëshuar datë 20.04.2018-19.04.2019

Dëshmi kualifikimi lëshuar nga Trup Certifikues TPCE për z. R.S, profesion Instalator termotek, lëshuar datë 20.04.2018-19.04.2019

Dëshmi kualifikimi lëshuar nga Trup Certifikues TPCE për z. E.N, profesion hidro-termoteknik, lëshuar datë 20.04.2018-19.04.2019

Dëshmi kualifikimi lëshuar nga Trup Certifikues TPCE për z. A.S, profesion hidro-termoteknik, lëshuar datë 20.04.2018-19.04.2019

Dëshmi kualifikimi lëshuar nga Trup Certifikues TPCE për z. A.S, profesion mekanik, lëshuar datë 24.04.2018-23.04.2019

Dëshmi kualifikimi lëshuar nga Trup Certifikues TPCE për z. Q.D, profesion mekanik, lëshuar datë 24.04.2018-23.04.2019

Dëshmi kualifikimi lëshuar nga Trup Certifikues TPCE për z. F.Y, profesion saldator, lëshuar datë 24.04.2018-23.04.2019

Dëshmi kualifikimi lëshuar nga Inspektoriati Qëndror teknik për z. E.Z., profesion teknik/kondicioner /elektriciestsaldator lëshuar datë 26.03.2015.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gëmbra “b” e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “ [...] *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]”*

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, si edhe specififikimet teknike duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Në interpretimin teleologjik të nenit 46 pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, gjykon se qëllimi i normës së mësipërme juridike lidhet me vënien në dispozicion të

autoriteteve kontraktore të mekanizmave ligjor mbi vendosjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit me anë të cilave të vërtetohet se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, *profesionale për të përmbushur kontratën.*

III.1.5. Në nenin 9 pika 1 gërma “a” të ligjit nr. 8734 datë 01.02.2001 “*Për garantimin e sigurisë së punës të paisjeve dhe instalimeve elektrike*”, parashikohet se “*Formimi i punëmarrësve*” Punëdhënësi merr masat e nevojshme që: a) përdorimi i pajisjeve elektrike të bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, e lëshuar nga IPIE-ja ose nga komisioni i miratuar prej saj”. Në nenin 7 të ligjit nr.13/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8734 datë 01.02.2001 “*Për garantimin e sigurisë së punës të paisjeve dhe instalimeve elektrike*”, parashikohet se “Në nenin 9, shkronja “a” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë: “a) Përdorimi i pajisjeve elektrike bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, të lëshuar nga një organ i akredituar certifikues personeli për fushën përkatëse.”. Gjithashtu në nenin 5 pika 1 gërma “c” të ligjit nr.116/2014 “*Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë*” parshikohet se “*Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit akrediton: c) organe certifikuese të personelit;*”. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar ndryshimeve të lex specialis ligjit nr. 8734 datë 01.02.2001 “*Për garantimin e sigurisë së punës të paisjeve dhe instalimeve elektrike*” me anë të ligjit nr. 13/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8734 datë 01.02.2001 “*Për garantimin e sigurisë së punës të paisjeve dhe instalimeve elektrike*”, parashikohet se Përdorimi i pajisjeve elektrike bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, të lëshuar nga një organ i akredituar certifikues personeli për fushën përkatëse.” Sa më sipër, K.P.P. gjykon se kuadri ligjor në fuqi nuk parashikon mundësinë e certifikimit të punonjësve të subjekteve juridike pranë një organi shtetëror (ish Inspektoritati Qëndror Teknik (IQT) sot Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), por parashikohet se dëshmia e aftësisë lëshohet nga subjekte juridike private, por që plotësojnë kushtin që të jenë të akredituar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Në këtë kuptim, në harmoni me ligjin nr. 116/2014 “*Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë*” parshikohet se “*Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit akrediton: c) organe certifikuese të personelit;*”. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar kuadrin ligjor në fuqi, subjektet juridike, gëzojnë të drejtën që të trajnojnë/certifikojnë stafin e tyre në subjekt juridikë jo publikë (privatë) me kusht që këto të fundit të jenë të certifikuar që në rastin konkret punonjësi E.Z., me profesion teknik/kondicioner/elektricitist/saldator i pajisur me dëshminë e kualifikimit në datën 26.03.2015 të lëshuar nga Inspektoriati Qëndror Teknik nuk është e vlefshme në kuptim ligjit. Akoma më tej Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në bazë të ligjit nr. 8734 datë 01.02.2001 “*Për garantimin e sigurisë së punës të paisjeve dhe të instalimeve elektrike*”, të ndryshuar dhe Rregullores të “*Sigurisë dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike*” Kapitulli I pika 1-12 parashikon konkretisht se: [...]Kontrolli i njohurive mbi sigurimin teknik bëhet një herë në vit.[...]. Ndërsa në pikën 1-14 [...]Komisioni pasi merr në provim punonjësit përcakton grupin e kualifikimit të sigurimit teknik duke e vlerësuar: Fiton ose nuk fiton. Këto përfundime regjistrohen në librin e provimeve dhe në librezën personale që ka çdo punonjës[.]

III.1.7. Rrjedhimisht Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik “Sulollari” sh.p.k. nuk ka dëshmuar se stafi i tij i propozuar për realizimin e kontratës dhe konkretisht specialisti E.Z., me profesion teknik/ kondicioner/elektricitist/saldator i pajisur me dëshminë e kualifikimit në datën 26.03.2015, të lëshuar nga Inspektoriati Qëndror Teknik është brenda afatit të

vlefshmërisë në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor, si dhe me kuadrin ligjor në fuqi. Në këtë kuptim, Komisioni i Prokurimit Publik në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, gjykon se, operatori ekonomik “Sulollari” sh.p.k. nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor në lidhje me stafin për punonjësin e kualifikuar sipas legjislacionit në fuqi. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mospranojë ankesën e paraqitur nga kandidati blerës “Sulollari” sh.p.k. për procedurën e ankandit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-59831-03-29-2018, me objekt : *Loti 3 “Riparim Mirëmbajtje e Sistemeve të Ngrohjes dhe të ujit sanitar me kaldaja, sistemeve të ngrohjes-ftohjes me chillera, të stacionit qëndror të pompave dhe sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm, të elektropomave, në godinat e shërbimeve spitalore në QSUT*”, me fond limit 19,943,547 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 27.04.2018 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë.
2. Autoriteti Kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1003 protokoli Datë 25.05.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha